

Vendim nr. 28, datë 23.01.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 23.01.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 20 (I) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ILIR MUZHAQI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-2021, datë 10.12.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në gjykimin e zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ka rezultuar se kërkuesi, gjatë vuajtjes së dënimit me burgim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (*IEVP*), Rrogozhinë, në datën 02.09.2020, ka kundërshtuar punonjësit e policisë. Për këtë arsye, nga *IEVP*-ja, Rrogozhinë, ka nisur procedura për dhënien e masës disiplinore për të. Në përfundim të procedurave disiplinore, komisioni disiplinor i *IEVP*-së, Rrogozhinë, ka vendosur dhënien e masës disiplinore “10 ditë përjashtim nga ajrosja në grup” ndaj kërkuesit,

me motivacionin “Moszbatimi i urdhrave të personelit të institucionit ose vonimi i pajustificuar në zbatimin e tyre”.

2. Për ankimin e kërkuetit, Komisioni i Apelit të Masave Disiplinore (*KMAD*) pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve ka vendosur lënien në fuqi të masës disiplinore të dhënë ndaj kërkuetit nga komisioni disiplinor në IEVP-në, Rrogozhinë. Në këto kushte, kërkueti i është drejtuar juridiksionit gjyqësor, duke kërkuar shfuqizimin e masës disiplinore.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 12-2020-1844/458, datë 17.12.2020, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuetit, me objekt shfuqizimin e aktit që ka vendosur masën disiplinore, si të pabazuar në prova e në ligj. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim kërkueti.

4. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2021-1112 (187), datë 21.06.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit penal nr. 12-2020-1844/458, datë 17.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkueti.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2021, datë 10.12.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

6. Në datën 18.11.2025, sipas shënimit të shërbimit postar, kërkueti ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), i cili është regjistruar në datën 19.11.2025.

II

Pretendimet e kërkuetit

7. **Kërkueti**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se ndaj tij nuk është zhvilluar një proces i rregullt ligjor, duke argumentuar se i është cenuar *parimi i paanshmërisë*, pasi gjyqtari I.P., i cili ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar rekursin e kërkuetit në Gjykatën e Lartë ka shqyrtuar më parë rekursin e paraqitur nga kërkueti në lidhje me vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës që nuk ka pranuar kërkesën e tij për përjashtimin e gjyqtarit I.D. Pra, sipas kërkuetit, i njëjti gjyqtar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë ka dhënë dy vendime për të njëjtin procedim.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1,

shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative. Në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuesin. Në këtë drejtim, Kolegji evidenton se mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

10. Në kuptim të sa më sipër, në vlerësimin paraprak të respektimit të kriterëve të legjitimitit për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, në drejtim të pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi në mbështetje të ankimit kushtetues individual, Kolegji vëren se ato kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak është cenuar *parimi i paanshmërisë*, pasi gjyqtari I.P., i cili ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar rekursin e kërkuesit në Gjykatën e Lartë, ka shqyrtuar më parë rekursin e paraqitur nga kërkuesi, në lidhje me vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës që nuk ka pranuar kërkesën e tij për përjashtimin e gjyqtarit I.D. Pra, sipas kërkuesit, i njëjti gjyqtar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë ka dhënë dy vendime për të njëjtin procedim.

11. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se respektimi i *parimit të paanshmërisë*, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, duhet të verifikohet duke aplikuar testin *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose të interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar, si dhe testin *objektiv*, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë. Veçanërisht

për sa i përket kriterit të dytë, nëse ky zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshëmrisht i bazuar (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 49, datë 16.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Po kështu, Kolegji konstaton se në zbatim të detyrimeve të përcaktuara nga neni 42 i Kushtetutës, nenet 15 dhe 16 të Kodit të Procedurës Penale kanë parashikuar rastet e papajtueshmërisë me funksionin e gjyqtarit në gjykim, ku përfshihen papajtueshmëria për shkak të pjesëmarrjes në procedim, si dhe papajtueshmëria për arsye lidhjeje familjare, gjinie ose krushqie. Neni 18 i këtij kodi ka përcaktuar të drejtën e palëve për të kërkuar përjashtimin e gjyqtarit si në rastet e parashikuara nga nenet 15, 16 e 17 të këtij kodi, ashtu edhe kur gjatë ushtrimit të funksioneve dhe përpara se të jetë dhënë vendimi ai ka shfaqur mendimin e tij për faktet ose rrethanat objekt procedimi.

13. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se në datën 28.04.2021 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Apelit Durrës me kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit I.D. nga gjykimi i ankimit të tij ndaj vendimit të komisionit disiplinor të IEVP-së, Rrogozhinë, që ka vendosur dhënien e masës disiplinore “10 ditë përjashtim nga ajrosja në grup” ndaj kërkuesit, me argumentin se ai gjyqtar ka marrë pjesë në dhënien e disa vendimeve ku procedohej në bazë të ankimeve të paraqitura nga ai në gjykatën e apelit, dhe se në ato procese ka kryer veprime në kundërshtim me ligjin, duke dëmtuar me dashje interesat e kërkuesit.

14. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës nga një tjetër gjyqtar tjetër i Gjykatës së Apelit Durrës është vendosur rrëzimi i saj, për shkak se nuk rezultonte që gjyqtari I.D. të ketë shfaqur paraprakisht mendimin për zgjidhjen në themel të çështjes dhe nuk verifikohet ekzistenca e asnjë prej rrethanave të përcaktuara në nenin 18 të KPP-së që vinin në dyshim paanshinë e pretenduar të gjyqtarit. Vendimmarrja e Gjykatës së Apelit Durrës është kundërshtuar nga kërkuesi në Gjykatën e Lartë, Kolegji Penal i së cilës, me vendimin nr. 00-2021-545, datë 23.07.2021, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga nenet 22 dhe 432 të KPP-së. Në Kolegjin Penal që ka shqyrtuar rekursin e kërkuesit për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, që ka vendosur rrëzimin e kërkesës së tij për përjashtimin e gjyqtarit I.D., një prej anëtarëve të trupit gjykues ka qenë edhe gjyqtari I.P. Po kështu, Kolegji vëren se në shqyrtimin e rekursit të kërkuesit për themelin e çështjes, ku është vendosur mospranimi i tij, një prej anëtarëve të

trupit gjykues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka qenë përsëri gjyqtari I.P. për të cilin ka ngritur pretendimin kërkuesi, i cili ka shqyrtuar edhe rekursin ndaj vendimit të gjykatës së apelit për rrezimin e kërkesës së tij për përjashtimin e gjyqtarit I.D.

15. Për sa më lart, në analizë të vendimmarrjeve të mësipërme të Gjykatës së Apelit Durrës dhe të Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se në rastin konkret bëhet fjalë për dy procese që kanë pasur objekte të ndryshme. Kështu, procesi i parë ka të bëjë me kërkesën e kërkuesit për përjashtimin e gjyqtarit I.D. nga shqyrtimi i çështjes së tij në Gjykatën e Apelit Durrës, ndërsa procesi objekt i ankimit kushtetues individual ka të bëjë me kërkesën e kërkuesit për shfuqizimin e vendimit të komisionit disiplinor të IEVP-së, Rrogozhinë, që ka vendosur dhënien e masës disiplinore ndaj tij. Në këtë këndvështrim, Kolegji evidenton se thjesht fakti i pjesëmarrjes të të njëjtit gjyqtar në gjykimin e kërkesës së kërkuesit për përjashtimin e gjyqtarit nga shqyrtimi i çështjes dhe kërkesës për shfuqizimin vendimit të komisionit disiplinor të IEVP-së, Rrogozhinë, nuk është i mjaftueshëm në kuptim të testit subjektiv dhe atij objektiv të paanshmërisë për të vënë në diskutim respektimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme. Vazhdimësia e qëndrimit në vendimmarrjen e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk përbën në vetvete ndonjë shkak për mungesën e paanshmërisë. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të paanshmërisë, si rrjedhojë e shqyrtimit nga gjyqtari I.P. të rekursit të tij ndaj vendimit nr. 10-2021-1112 (187), datë 21.06.2021 të Gjykatës së Apelit Durrës, është haptazi i pabazuar.

16. Në këndvështrim të sa më lart, për shkak të karakterit kumulativ të tyre, Kolegji evidenton se nuk është e nevojshme analiza e mëtejshme të plotësimit të kriterëve të tjera të legjitimitetit të ankimit kushtetues individual të kërkuesit.

17. Si përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.